



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:029040 C. nr. 472/2024
Datë: 27.02.2025
Numri i dokumentit: 06913904

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me zyrtaren Ligjore D.Ç. në çështjen kontestimore sipas padisë së paditësit F.T. nga Fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson B.K. Avokat nga Prizreni, kundër të paditurit: S.I.T. nga fshati Komuna e Prizrenit, për vërtetimin e pronësisë, jashtë seancës, me datë 27 Shkurt 2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

Konstatohet e tërhequr padia në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi F.T. nga Fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson B.K, Avokat nga Prizreni me date 25.01.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurit S.I.T. nga fshati Komuna e Prizrenit, për vërtetimin e pronësisë me padinë e paraqitur kundër të paditurit, ka kërkuar nga gjykata miratimin e kërkesëpadiisë.

Me parashtrësën e datës 25 Shkurt 2025, paditësi përmes të autorizuarit të tij e njofton gjykatën se e tërheq padinë në këtë çështje pasi që me palën e paditur kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore.

Pasi që pala paditëse përmes parashtrësës deklarohet se e tërheq padinë në këtë çështje, gjykata në kuptim të nenit 261 par. 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, konstaton se padia është tërhequr në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr. 472/2024 datë 27 Shkurt 2025

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda afatit 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.